REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisoni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

"MBI MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR FAMILJEN E Z.EDMOND MITA"

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetur bazuar në pikën 34 dhe 45 të nenit 2, si dhe nenet 33 dhe 34 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 459, datë 03.07.2019 "Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin"

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Bazuar në germën "c" "Kushtet sociale të familjes" të nenit 16 "Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve" të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", familja e Edmond Mitës përbëhet nga tre persona dhe plotëson tre kushtet si më poshtë:

1. **Kushtin e strehimit**, pasi familja është kthyer nga emigrimi dhe ka jetuar për një periudhë me qira, por për shkak të pamundësisë financiare për të paguar qiranë mujore është nxjerrë nga banesa. Më pas, për një periudhë kohe, ka jetuar në kushte të papërshtatshme, përfshirë trotuaret e rrugës së Kalasë, dhe më vonë është strehuar në ambientet e një kulti fetar.
2. **Kushtin social**, si familje "emigrantë të rikthyer".
3. **Kushtin ekonomik**, duke qenë aktualisht familje pa të ardhura.

Situata Financiare

Familjet që plotësojnë të tre këto kushte, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", kanë përparësi në trajtimin e kërkesës për strehim. Duke qenë se kjo familje e kishte të pamundur të siguronte në tregun e lirë një banesë me kontratë qiraje për shkak të mosbesimit të pronarëve lidhur me pagesën e rregullt të qirasë mujore, Bashkia u detyrua të marrë me qira një banesë në tregun e lirë, duke lidhur kontratë qiraje para noterit me nr. 558 repertori, nr. koleksioni 338, datë 11.02.2026. Banesa është e mobiluar, ndodhet në lagjen "30 Vjetori", me nr. pasurie 15/241+1-15, me sipërfaqe 74 m², për ta dhënë me kontratë nënqiraje familjes së z. Edmond Mita. Sa më sipër, kërkojmë miratimin e bonusit të qirasë për familjen e z. Edmond Mita për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga data 11.02.2026 deri më 11.02.2027, në vlerën 233,933 (dyqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

1. Drejtoria e Menaxhimit Financiare si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Mjedisit.

A është objekt i konsultimit publik:

Ky material nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Përhershëm për " **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**" , i mbledhur në datën 27/02/2026, shqyrtoi projekt vendimin **"MBI MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR FAMILJEN E Z.EDMOND MITA"**

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit të qirasë për familjen e Z.Edmond Mita për periudhën 11.02.2026 - 11.02.2027 në vlerën 233,933 (dyqind e tridhjet e tremijë e nëntëqind e tridhjet e tre) lekë

Vlera e bonusit të qirasë do të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe nga buxheti i bashkisë

Komisoni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 27/02/2026